



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 8, datë 9.1.2025

P Ë R

PËRCAKTIMIN E STANDARDEVE TË PLANIT
TË SIGURISË E TË ELEMENTEVE TË MBROJTJES
PËR SIPËRFAQEN PËR KULTIVIM DHE PËRPUNIM TË BIMËS
SË CANNABIS-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE
DHE RREGULLAVE TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE
TË DEDIKUARA TË TRANSPORTIT TË LËNDËVE TË PARA
DHE PRODUKTEVE, QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET
E LICENCUARA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “d” dhe “e”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton standardet e planit të sigurisë dhe elementeve të mbrojtjes për sipërfaqen për kultivim dhe përpunim të bimës së *cannabis-it* për qëllime mjekësore dhe rregullat e lëvizjes së automjeteve të dedikuara të transportit të lëndëve të para e të produkteve, që duhet të plotësojnë subjektet e licencuara.
2. Ky vendim ka për qëllim miratimin e rregullave për personat juridikë që paraqesin kërkesë për licencë për prodhimin e *cannabis-it* mjekësor, sipas përcaktimeve të shkronjave “d” dhe “e”, të pikës 2, të nenit 15, të

ligjit nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”.

3. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

- a) **“Ambient i hapur”** është ambienti i kultivimit në natyrë pa shtresa mbrojtjeje apo mbuluese.
- b) **“Ambient i mbrojtur”** është një mjedis i kontrolluar dhe i mbuluar, i cili krijon kushte të favorshme për rritjen e bimëve, duke i mbrojtur ato nga ndikimet atmosferike të jashtme, si ndryshimet ekstreme të temperaturës, era apo reshjet e shiut. Ky ambient lejon depërtimin e rrezatimit diellor dhe zakonisht përfshin struktura si sera ose tunele plastike, që ofrojnë një shkallë të caktuar kontrolli mbi temperaturën, lagështinë dhe dritën.
- c) **“Ambient i mbyllur”** është një mjedis plotësisht i kontrolluar, i mbuluar dhe izoluar nga ndikimet e jashtme atmosferike, i cili ofron kushte të favorshme për rritjen e bimëve pa depërtimin e rrezatimit natyror diellor. Ky lloj ambienti përdor ndriçim artificial dhe sisteme të kontrolluara për parametrat, si drita, lagështia, temperatura, ventilimi dhe për ndikimin e faktorëve të tjerë të jashtëm, duke siguruar kushte optimale për kultivimin.
- ç) **“Subjekt i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike”** është SHPSF-ja e pajisur me licencë të nënkategorive 1.3.A. dhe 1.3.B ose *“Illyrian Guard”*, sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin privat të sigurisë fizike.

II. STANDARDET E PLANIT TË SIGURISË PËR SIPËRFAQEN PËR KULTIVIMIN DHE PËRPUNIMIN E *CANNABIS-IT* DHE ELEMENTET E MBROJTJES, RRETHIMIT, SIGURISË ME TELEKAMERA DHE SIGURIMIT FIZIK PËR 24 ORË, ELEMENTET PENGUESE PËRPARA HYRJES DHE TEL ME GJEMBA MBI GARDHIN

1. Subjekti i licencuar në ambientet ku ushtrohet aktiviteti duhet të plotësojë standardet e mëposhtme:

- a) Ambientet duhet të jenë të monitoruara në vazhdimësi me sistem të kamerave CCTV, i pajisur me *reader* të inkorporuar dhe sensorë lëvizjeje, me rezolucion të lartë, prej të paktën 1280 x 720, me rreze infra të kuqe, përfshirë hapësirën 20 metra jashtë rrethimit, e cila duhet të jetë e ndriçuar. Imazhet filmike të sistemit të kamerave duhet të ruhen të paktën për 90 ditë në NRV/Server dhe të paktën për një

- periudhë 1-vjeçare në memorie “*Cloud*” me vendndodhje në një nga vendet e BE-së;
- b) Sistemi i kamerave CCTV monitoron sipërfaqen, brenda dhe jashtë ambienteve të njësisë së prodhimit, duke u orientuar në mënyrë që të sigurohet identifikim i qartë dhe i sigurt i ambienteve dhe i të gjithë individëve që aksesojnë apo lëvizin brenda tyre apo në ambientet e jashtme pranë rrethimit;
 - c) Përdorimi i pajisjeve elektronike të teknologjisë së lartë, në funksion të sigurisë (detektorë, ura kontrolli);
 - ç) Në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe në bashkëpunim me strukturat e Policisë së Shtetit, lidhja e sinjalit të alarmit, në nivel qendror dhe/ose vendor, me sallat e komandimit/informacionit të Policisë së Shtetit;
 - d) Sipërfaqja ku ushtrohet aktiviteti ruhet 24 orë pa ndërprerje nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike që përfshin dhe shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh;
 - dh) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të hapura ose të mbrojtura rrethohet nga jashtë me mur betoni të qëndrueshëm me trashësi të paktën 25 (njëzet e pesë) cm dhe lartësi 4 m nga toka, mbi të cilin vendoset tel me gjemba;
 - e) Për rastet kur kultivimi kryhet në ambiente të mbyllura, muri i jashtëm i godinës duhet të jetë mur betoni i qëndrueshëm me trashësi të paktën 25 cm;
 - ë) Hyrja në ambientet e njësisë është e kufizuar dhe mundësohet përmes një porte hekuri që garanton aksesin vetëm për personat dhe mjetet e autorizuar, si dhe monitorohet nga sistemi i kamerave CCTV, të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike;
 - f) Porta e hyrjes kontrollohet nga personel i autorizuar për sigurinë, i cili mban evidencë për çdo hyrje-dalje të personave, automjeteve dhe mallrave;
 - g) Materialet teknike, të cilat garantojnë sigurinë dhe monitorimin, vendosen në një dhomë të veçantë të dedikuar brenda perimetrit të sipërfaqes ku ushtrohet aktiviteti, në të cilën ka akses vetëm personeli përgjegjës për sigurinë.
2. Subjekti i licencuar paraqet vetëdeklarim për gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike për të garantuar aksesin për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike, sipas formatit të vetëdeklarimit të përcaktuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Mbajtësi i licencës duhet të ketë dhe të ndjekë procedura për të ruajtur dhe testuar efikasitetin e pajisjeve e të sistemeve të sigurisë. Mbajtësi i licencës

duhet të kryejë inspektime periodike të pajisjeve dhe infrastrukturës nga subjekte të licencuara për këtë qëllim.

4. Skema e sigurisë së objektit së bashku me procedurat e sigurisë, planin e dislokimit dhe transportin e sigurt të *cannabis*-it përgatitet nga drejtuesi teknik i subjektit të ngarkuar për ruajtjen e sigurinë fizike dhe miratohet nga shefi i Komisarariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti dhe hartohet në 4 (katër) kopje origjinale të cilat i vendosen në dispozicion nga 1 (një) kopje subjektit, Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it (Agjencia), subjektit të ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisarariatit të Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.
5. Në rast defekti të sistemeve të sigurisë, subjekti i licencuar ose subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike, në varësi të parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve, ka detyrimin të bëjë riparimin e menjëhershëm, por jo më shumë se 24 orë nga defekti. Subjekti njofton menjëherë Agjencinë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.
6. Ruajtja dhe sigurimi i ambienteve ku ushtrohet aktiviteti kryhet nga subjekti i ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike në bazë të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, në zbatim të përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi.
7. Kontrata hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje origjinale të cilat depozitohen nga 1 (një) kopje për subjektin, Agjencinë, subjektin e ngarkuar për ruajtjen dhe sigurinë fizike dhe Komisariatin e Policisë të juridiksionit ku ndodhet objekti.

III. RREGULLAT DHE TARIFAT PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES PËR RUAJTJEN DHE SIGURINË FIZIKE, SI DHE PËR LËVIZJEN E AUTOMJETEVE TË DEDIKUARA PËR TRANSPORTIN E LËNDËVE TË PARA DHE PRODUKTEVE E NËNPRODUKTEVE TË *CANNABIS*-IT PËR QËLLIME MJEKËSORE

1. Rregullat që duhet të ndiqen nga subjekti i licencuar për lidhjen e marrëveshjes për ruajtjen dhe sigurinë fizike, si dhe lëvizjen e automjeteve të dedikuara të tregtimit të lëndëve të para dhe produkteve janë, si më poshtë vijon:
 - a) Transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj duhet të kryhet me mjete të mbyllura që sigurojnë që ato të mos jenë të dukshme ose të identifikueshme nga jashtë automjetit dhe duhet të

- shoqërohen me procesverbalin përkatës për sasinë dhe llojin e produktit që transportohet.
- b) Transporti i bimës, nënprodukteve dhe produkteve të saj të destinuara për përdorim mjekësor, të prodhuara nga bima e *cannabis*-it nga prodhuesi i licencuar, duhet të bëhet me mjete transporti të tilla që të sigurojnë ruajtjen e barit në temperatura as më të larta e as më të ulëta sesa ajo që thuhet në etiketim ose fletudhëzuesin e barit.
 - c) Subjekti i licencuar duhet të sigurojë që automjeti i transportit të jetë i mbyllur, i vulosur dhe i pajisur me GPS, me qëllim monitorimin pa ndërprerje të lëvizjes nga origjina në destinacion dhe të ketë kamera që monitorojnë materialin që transportohet, si dhe të ruhet dhe të shoqërohet nga shërbim i sigurisë deri në/nga pika e kalimit të kufirit sipas parashikimeve në marrëveshjen e lidhur mes palëve.
 - ç) Çdo lëvizje apo transportim kryhet vetëm pas marrjes së autorizimit nga Agjencia e cila miraton dhe datën e propozuar të lëvizjes apo transportit, sipas formatit të miratuar nga kjo e fundit.
 - d) Në çdo rast, për çdo lëvizje, transportim të farërave, fidanëve, lëndës së parë, të bimës së *cannabis*-it mjekësor, nënprodukteve dhe produkteve përfundimtare të saj dhe mbetjeve/produkteve që asgjësohen nga një vend në një vend tjetër, subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para lëvizjes së planifikuar, përmes Regjistrat Kombëtar të aktiviteteve të licencuara dhe të lejuara të bimës së *cannabis*-it dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Njoftimi përmban informacion lidhur me oraret e lëvizjes, intenerarin përkatës, të dhënat për çdo mjet që bën transportin, si dhe punonjësit e shërbimit që shoqërojnë ngarkesën.
 - dh) Subjekti i licencuar i garanton Agjencisë akses të pakufizuar dhe në kohë reale në sistemin e kamerave që monitorojnë të gjitha ambientet e njësisë, si dhe sistemin e kamerave që monitorojnë transportin e çdo materiali të lidhur me *cannabis*-in mjekësor, si dhe në imazhet filmike të ruajtura.
 - e) Procedurat doganore të eksportimit mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të daljes nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të fillojnë në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit dhe të përfundojnë në zyrat doganore kufitare të daljes nga territori, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e eksportit të mallrave. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para procedurës doganore të import/eksportit Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.
 - ë) Procedurat doganore të importimit të farërave dhe fidanëve mund të kryhen pranë zyrave doganore kufitare të hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, ku kryhen edhe kontrollet për sigurinë e

mbrojtjen dhe, sipas rastit, këto procedura mund të kryhen në zyrat doganore të brendshme kompetente për territorin ku janë vendosur ambientet e kultivimit, në përputhje me legjislacionin doganor që rregullon procedurat e eksportit të mallrave. Subjekti i licencuar është i detyruar të njoftojë, të paktën 5 (pesë) ditë para procedurës doganore të import/eksportit Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Subjekti njofton jo më pak se 24 orë para mbërritjes së farërave dhe fidanëve institucionin përgjegjës për inspektimin fitosanitar në pikën e inspektimit kufitar ku do të hyjnë produktet.

2. Tarifat për shërbimet e sigurisë që u ofrohen subjekteve të licencuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore janë sipas shtojcës nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it, subjektet e licencuara, si dhe subjektet e ngarkuara për ruajtjen dhe sigurinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I BRENDSHËM

ERVIN HOXHA

**MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

ANILA DENAJ

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSMINISTRI

ARIAN JAUPLARI

**MINISTRI I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

ALBANA KOÇIU

Shtojca nr. 1

Model i vetëdeklarimit për gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike

VETËDEKLARIM PËR GATISHMËRINË PËR TË LIDHUR MARRËVESHJE ME STRUKTURËN PËRGJEGJËSE TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR RENDIN DHE SIGURINË PUBLIKE

Në mbështetje të shkronjës “e”, të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr.61/2023, “Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *cannabis-it* dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale”,

Unë i nënshkruari _____,
(emër, atësia, mbiemër)

Deklaroj gatishmërinë për të lidhur marrëveshje me strukturën përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, në nivel qendror dhe vendor, për të garantuar aksesin për inspektim ndaj shoqërisë private të sigurisë fizike që mbikëqyr mjediset e kultivimit të bimës së *cannabis-it* dhe nënprodukteve të saj, si dhe lëvizjes së automjeteve të dedikuara të tregtimit të lëndëve të para dhe produkteve sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave nr. ____ datë ____.

Përfaqësuesi i personit juridik

(Emër mbiemër, firme, vulë)

Shtojca nr.2

Tarifat për shërbimin që u ofrohen subjekteve të licencuara për kultivimin dhe përpunimin e *cannabis*-it për qëllime mjekësore:

TARIFAT E SHËRBIMEVE		
I	SHËRBIM RUAJTJEJE ME PUNONJËS SHËRBIMI SIGURIE (për ambiente, urë/tra kontrolli, etj)	
	<i>Lloji i shërbimit të ofruar</i>	<i>Tarifë/punonjës në muaj (lek pa TVSH)</i>
1	Shërbim ruajtjeje me një punonjës shërbimi (tri turne)	87 900
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i parë)	76 000
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i dytë)	80 700
	Shërbim sigurie me urë kontrolli për një punonjës (turni i tretë)	107 000
II	SHËRBIM REAGIMI ME GRUP VERIFIKIMI SINJALESH	
	<i>Lloji i shërbimit të ofruar</i>	<i>Tarifë/muaj (lek pa TVSH)</i>
	Shërbim reagimi me grup verifikimi sinjalesh	11 300
III	SHËRBIM RUAJTJEJE ME SISTEME ELEKTRONIKE*	
	<i>Lloji i shërbimit të ofruar</i>	<i>Tarifë/shërbim në muaj (lek pa TVSH)</i>
	Shërbim sigurie për vëzhgim me kamera, dhe alarm	11 800
IV	SHËRBIM SIGURIMI PËR TRANSPORTIN	
	<i>Shërbim</i>	<i>Tarifë/ditë për lëvizje (lek pa TVSH)</i>
1	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (deri në 50 km)	14 800
2	Shërbim ruajtjeje me shoqërim gjatë transportit me një makinë (për çdo 50 km shtesë)	29 600

* Pajisjet elektronike ose trau i parkimit, bravat elektrike, sistemi *face detection*, akses kontrolli, mund të vihen në dispozicion nga subjekti i licencuar ose subjekti që ofron shërbimin e sigurisë fizike sipas përcaktimeve në marrëveshjen e lidhur me palëve. Nëse pajisjet ofrohen nga subjekti i ngarkuar me shërbimin e sigurisë pagesa e tyre përcaktohet sipas marrëveshjes së lidhur mes palëve.

NR.PROT. 7163/2
DATE 9.1.2025

MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË
SHTETIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË KONTROLLIT TË
CANNABIS-IT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

